



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

Nr. 380/6 prot.

Tiranë, më 27. 7. 2021

**URDHËR**

Nr. 1028, datë 27. 7. 2021

**PËR**

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT “POLITIKA DHE PROCEDURAT E REKRUTIMIT  
TË KANDIDATËVE PËR OFICER TË RINJ NË FORCAT E ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në germën “f” dhe “nj”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e dokumentit “Politika dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë e pandarë e tij.
2. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 925, datë 03.08.2020 “Për miratimin e dokumentit “Politika dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr. 332, datë 10.03.2021, shfuqizohet.
3. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Personelit (J-1), Qendra e Personel-Rekrutimit, Akademia e Forcave të Armatosura dhe të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.
4. Ndjekin zbatimin e urdhrit shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

  
MINISTRI  
Niko Peleshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

**POLITIKA DHE PROCEDURAT  
E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE PËR OFICERË TË RINJ NË FORCAT E  
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes

Nr. 1028, datë 27. 7. 2021

Korrik 2021

## KREU I

### POLITIKA E REKRUTIMIT TË PËRGJITHSHME

#### 1. Hyrje.

Politika e rekrutimit të kandidatëve për oficerë në Forcat e Armatosura përmban parimet, kërkesat dhe standardet për rekrutimin dhe plotësimin e strukturave të FA-së me oficerë të rinj, në funksion të misionit të mbrojtjes së vendit dhe të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe angazhimeve në kuadrin e NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Zbatimi i kësaj politike do të ketë në themel harmonizimin e arsimit të lartë e profesional në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare me sistemin e arsimit të lartë në vend, si dhe sigurimin e ndërveprueshmërisë me sistemet më të mira të arsimit të kualifikimit ushtarak të vendeve të NATO-s. Burimet e mbështetjes ligjore janë ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të FARSH”, i ndryshuar; ligji 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucion i vetëm i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”.

Rekrutimi i kandidatëve për oficerë përbën një nga aspektet më themelore të menaxhimit të ciklit jetësor të personelit ushtarak dhe është me rëndësi jetike për të ardhmen e FA-së. Për këtë arsye, rekrutimi i kandidatëve për oficerë, sipas standardeve të NATO-s, është një nga çështjet thelbësore të kësaj politike dhe i Strategjisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2020-2024.

#### 2. Qëllimi.

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i drejtimeve kryesore, i vizionit dhe i parimeve për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, përcaktimi i metodologjisë së kërkimit dhe kriterëve të përzgjedhjes së tyre, si dhe i detyrave dhe përgjegjësi të strukturave për drejtimin dhe menaxhimin e procesit.

#### 3. Vizioni dhe Parimet.

Stadi i ri i zhvillimit të Forcave të Armatosura shtrën kërkesën e rekrutimit dhe mbajtjes së personelit ushtarak cilësor. Kjo shtrën nevojën e përmirësimit të standardeve për rekrutimin e personelit më të mirë, në funksion të plotësimit të nevojave që kanë Forcat e Armatosura.

Zhvillimi i teknologjisë dhe modernizimi i sistemeve kërkon njerëz të aftë për të vepruar në një mjedis të ri, kompleks dhe sfidues. Një forcë tërësisht profesioniste do të kërkojë plotësimin me oficerë të aftë për të gjitha specialitetet, llojet e forcave dhe shërbimeve, në përputhje me nevojat e FARSH-it.

Shumëllojshmëria e misionëve që kryejnë Forcat tona të Armatosura, kërkon personel të motivuar dhe të mirëkualifikuar për të siguruar plotësimin e detyrave që rrjedhin prej tyre.

Rekrutimi i kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura do të bazohet në parimin se oficerët janë pjesë e rëndësishme e shoqërisë, e cila është mirënjohëse për shërbimet e tyre. Në këtë kontekst, oficerët do të vijojnë edhe gjatë shërbimit në Forcat e Armatosura të arsimohen, kualifikohen dhe të trajnohen jo vetëm për shërbim cilësor gjatë qëndrimit në FA, por edhe për të mundësuar integrimin e plotë të tyre në tregun e punës, pas përfundimit të shërbimit në strukturat e FA-së.

Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u duhet të rekrutojnë një numër relativisht të kufizuar kandidatësh për oficerë të rinj në vit. Kriteret për kandidatë për oficerë duhet të mbajnë parasysh nevojat dhe zhvillimet koherente të situatës së mbrojtjes dhe sigurisë, për të qenë të ndërveprueshëm me NATO-n, si dhe angazhimet në rritje për pjesëmarrje jo vetëm në operacione, por edhe për plotësimin me personelin e kërkuar të strukturave të NATO-s, për kohë paqe.

Përcaktimi dhe vendosja e kërkesave për standardet e rekrutimit dhe pranimi vetëm i kandidatëve më cilësorë do të jenë shtyllat kryesore ku do të mbështetet politika e rekrutimit të oficerëve të rinj.

Në një forcë ushtarake moderne, si kjo që po ndërtojmë, ku drejtimi, metodologjia dhe pajisjet po bëhen gjithnjë e më shumë komplekse dhe ku informacioni është kthyer në faktor, Forcat e Armatosura janë të interesuara të rekrutojnë kandidatë me cilësi të larta. Për këtë arsye do të përdorim forma të larmishme për rekrutimin e kandidatëve për oficerë. Kryesisht do të mbështetemi në rekrutimin e shtetasve që kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë (të përgjithshëm ose profesional) brenda ose jashtë vendit. Ndërkohë do të rekrutojmë kandidatë cilësorë edhe nga shtetasit që kanë mbaruar arsimin e lartë, të cilët do të rekrutohen kryesisht për plotësimin e nevojave të Forcave të Armatosura me oficerë të rinj në disa specialitetet të veçanta.

Forcat e Armatosura, për të ruajtur vazhdimësinë e vlerave profesioniste të krijuara, do të rekrutojnë kandidatë për oficerë edhe nga radhët e ushtarëve/detarëve dhe nënoficerëve aktivë të përzgjedhur e të kualifikuar.

Rekrutimi i kandidatëve për oficerë të rinj do të rregullohet nëpërmjet lidhjes së kontratave të shërbimit, sipas ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Kontrata do të përmbajë të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve, kandidatit për oficer/kadetit dhe Forcave të Armatosura, si dhe penalitetet në rast shkelje të kontratës. Çdo kadet që hyn në Akademinë e Forcave të Armatosura, do të nënshkruajë një kontratë e cila përfshin periudhën e studimeve plus 6 vjet shërbim pas titullimit oficer, me të drejtë ripërtëritje maksimumi edhe për 6 vjet të tjera.

Celësi i shndërrimit të civilëve të arsimuar në oficerë do të jetë kryesisht përzgjedhja e djemve dhe vajzave, të cilët shfaqin dëshirë dhe kanë cilësi të përshtatshme për të shërbyer në Forcat e Armatosura. Testimi përzgjedhës i kandidatëve për oficerë të rinj duhet të bazohet në standarde të mirëpërcaktuara intelektuale, fizike, shëndetësore, objektive, rigorozë, gjithëpërfshirëse dhe të matshme. Testimi psikologjik duhet të dallojë ata individë që thjesht duan një punë, nga ata që janë të motivuar për t’i shërbyer vendit si oficerë aktivë, kudo që e kërkojnë misionet dhe detyrat e Forcave të Armatosura dhe mundësisht të përcaktojnë edhe prijet e tyre. Për këto arsye, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, mbështetur në ligjet në fuqi dhe në nevojat për forcën e ardhshme, do të përcaktojë kërkesat për standardet dhe kriteret arsimore, shëndetësore, fizike, intelektuale, të motivimit etj.

Planifikimi i rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj do të mbajë parasysh plotësimin e nevojave të strukturave të Forcave të Armatosura, sipas numrit dhe specialiteteve të parashikuara në Tabelat e Organizimit dhe Pajisjes. Ky planifikim duhet të parashikojë numrin dhe specialitetet e ushtarakëve oficerë aktivë që do të nxirren në rezervë (lirim, pension) në vitet pasardhëse; numrin dhe specialitetet e studentëve që aktualisht vijnë në arsimohen në shkolla ushtarake e civile brenda dhe jashtë vendit; përqindjet e humbjeve gjatë fazave të trajnimit, arsimimit dhe gjatë shërbimit në Forcat e Armatosura; detyrimet e Forcave tona të Armatosura për plotësimin me personel të strukturave të NATO-s, pjesëmarrjen në operacione jashtë vendit, si dhe ruajtjen e raportit të përcaktuar midis oficerëve meshkuj dhe femra (deri në 15%), si në numër të përgjithshëm, ashtu edhe për çdo strukturë në funksion të misioneve, detyrave dhe niveleve operacionale të kërkuara.

#### **4. Fusha e zbatimit.**

Kërkesat e politikës dhe procedurës për rekrutimin e kandidatëve për oficerë të rinj janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura.

#### **5. Objektivat.**

Objektivat kryesore janë:

- aplikimi i metodave më të mira që përdoren për rekrutimin e kandidatëve për oficerë;
- rekrutimi i kandidatëve për oficerë me një profil sa më cilësor dhe të devotshëm përmes përmirësimit të sistemit të përzgjedhjes dhe instrumenteve të vlerësimit;
- sigurimi i barazisë gjinore dhe shanseve të barabarta;
- ruajtja e standardeve profesionale gjatë rekrutimit;
- sigurimi i paanshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit dhe objektivitetit në procesin e përzgjedhjes.

#### **6. Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre.**

Strukturat që përfshihen në procesin e rekrutimit të kandidatëve për oficerë në FA janë:

- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DMBNJSH);
- Drejtoria e Personelit në SHP (J-1);
- Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR);
- Drejtoria e Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm (J-4);
- Akademia e Forcave të Armatosura (AFA);
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM);
- Policia Ushtarake (PU);
- Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së;
- Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura (NJMU);
- Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së (BMSHP).
- Inspektorati Shëndetësor në SHPFA;
- Qendra e Automatizimit.

##### **a) Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.**

Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve përgjigjet për:

- hartimin e politikës, procedurës dhe kritereve të rekrutimit të kandidatëve për oficerë, duke bashkëpunuar me J-1;
- monitorimin e zbatimit të politikës, procedurës dhe kritereve për përzgjedhjen e kandidatëve për oficerë të rinj;
- përmirësimin e politikës, procedurës dhe kritereve të rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj;
- bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit në SHP të FA-së për përcaktimin e nevojave;
- paraqitjen e nevojave dhe kërkesave për mundësitë e arsimimit të personelit tonë në institucionet arsimore ushtarake të vendeve të tjera, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave NATO dhe BE;
- njoftimin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për të drejtat e studimit që ofrojnë vendet e tjera për arsimimin e personelit tonë në institucionet arsimore ushtarake;
- fillimin e procedurave për rekrutimin e kandidatëve për oficerë të rinj;
- monitorimin e procesit;
- zhvillimin dhe ndjekjen e procedurave të miratimit të kandidatëve nga ministri;
- konfirmimin e kandidatëve të miratuar vendeve partnere që kanë ofruar të drejtat e studimit;
- përgatitjen e projekt-urdhrit për dërgimin me studime jashtë ose fillimin e studimeve në AFA.

**b) Drejtoria e Personelit në Shtabin Përgjithshëm të FA-së (J-1).**

Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm përgjigjet për:

- përcaktimin e nevojave të rekrutimit të kandidatëve për oficerë, sipas forcave dhe specialiteteve;
- inicimin e procedurave të rekrutimit dhe dërgimin e tyre në QPR, duke përcaktuar periudhat e studimit dhe mënyrën e trajtimit financiar;
- përcaktimin e fushës së diplomës universitare që kandidati duhet të ketë për t'u rekrutuar në FA në një specialitet të caktuar;
- dërgimin e planit të rekrutimit AFA-së, QPR-së dhe DMBNJSH-së, pas miratimit të tij nga SHSHP i FA-së;
- përgatitjen e urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm për QPR-në dhe AFA-në për rekrutimin e kandidatëve për oficerë;
- zbatimin e politikës, procedurës dhe kritereve të përcaktuara për rekrutimin e kandidatëve për oficerë;
- mbikëqyrjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve;
- ndjekjen e procedurave të përcaktuara për miratimin e kandidaturave që janë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit;
- përcjelljen e kandidaturave DMBNJSH-së, pasi ka marrë miratimin paraprak të SHSHP-së dhe është bërë verifikimi i plotësisë së kushtit të sigurisë nga strukturat përgjegjëse;
- bërjen e propozimeve për ndryshime në procedurat dhe kriteret e rekrutimit.

**c) Qendra e Personel-Rekrutimit.**

Qendra e Personel-Rekrutimit është struktura përgjegjëse për rekrutimin e kandidatëve për oficerë që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe

kandidatëve që do të ndjekin “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri”, në AFA, (të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë, minimumi diplomë bachelor).

Ajo përgjigjet për:

- hartimin e planit të veprimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë mbi bazën e planit të rekrutimit dhe urdhrit të SHSHP-së;
- publikimin e njoftimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, duke specifikuar kriteret, procedurat, dokumentacionin, afatet, testimet që do zhvillohen etj.;
- zhvillimin e marketingut në bashkëpunimin me QKMBMM-në dhe AFA-në, administrimin e aplikimeve, verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së dokumenteve të aplikantëve dhe të dhënave të deklaruara dhe zhvillimin e testeve;
- përzgjedhjen e kandidatëve;
- dërgimin e listës së kandidatëve fitues në NJMU, pranë Spitalit të Traumës, për kryerjen e ekzaminimit fiziko-shëndetësor, 60 ditë përpara fillimit të studimeve, me qëllim vlerësimin e aftësive fiziko-shëndetësore të tyre, për të qenë efektivë të FA-së;
- dërgimin e listës së kandidatëve fitues AISM-së dhe PU-së në momentin e përfundimit të testimit;
- dërgimin në Drejtorinë e Personelit në SHP, pas dërgimit nga AISM-ja dhe PU-ja, të listës përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas kuotave të miratuara;
- administrimin sipas rregullave të dokumentacionit të kandidatëve që kanë marrë pjesë në konkurrim;
- dërgimin e dosjeve të kandidatëve për oficerë në AFA, jo më vonë se 10 ditë nga momenti i daljes së urdhrit për ndjekjen e studimeve;
- përcaktimin e moshës maksimale të kandidatëve që do të rekrutohen, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e nenit 14, të ligjit 59/2014 “Për karrierën e ushtarakut në FA”, të ndryshuar dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të studimeve;
- gjatë periudhës së rekrutimit dhe jo vetëm, me personelin e saj dhe në bashkëpunim edhe me struktura të tjera, organizon dhe zhvillon takime dhe mban ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme të larta (vitin e 3-të) dhe studentët e vitit të fundit bachelor, me qëllim sensibilizimin e tyre për t’u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

#### ç) Drejtoria e Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-4).

Drejtoria e Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-4), në bashkëpunim me J-1 në SHP, QPR-në dhe AFA-në, merr masa për kompletimin me veshmbathje të studentëve që do të ndjekin studimet e ciklit të parë bachelor dhe të kursantëve që do të ndjekin “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri”, në AFA.

Përgatit urdhrin e SHSHPFA-së për vënien e mjeteve në dispozicion të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes/ AFA-së, për transportimin e kadetëve për në Shkollën e Trupës, në Bunavi.

#### d) Akademia e Forcave të Armatosura.

AFA-ja është struktura përgjegjëse për rekrutimin e kandidatëve për oficerë që do të ndjekin studimet bachelor në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe përgjigjet për:

- hartimin, miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit për programet e studimit ciklik i parë, i dytë dhe i tretë;

- hartimin e planit të masave për pranimin e aplikantëve/kandidatëve për oficerë mbi bazën e planit të rekrutimit dhe urdhrin të SHSHP-së;
- bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe publikimin e njoftimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, duke specifikuar kriteret, procedurat, dokumentacionin, afatet, testimet që do zhvillohen etj.;
- bashkëpunimin dhe koordinimin me QPR-në, J-1 dhe DMBNJSH, për zbatimin e procesit të rekrutimit;
- zhvillimin e marketingut në bashkëpunimin me QKMBMM-në dhe QPR-në;
- zhvillimin dhe administrimin e aplikimeve dhe verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së dokumenteve të aplikantëve dhe seleksionimin paraprak të aplikantëve/kandidatëve;
- zhvillimin e konkursit intitucional për përzgjedhjen e aplikantëve/kandidatëve;
- dërgimin e listës së kandidatëve fitues në NJMU, pranë Spitalit të Traumës, për kryerjen e ekzaminimeve fiziko-shëndetësore, me qëllim vlerësimin e aftësive fiziko-shëndetësore të tyre, për të qenë efektivë të FA-së;
- dërgimin e listës së aplikantëve/kandidatëve fitues AISM-së dhe PU-së me të dhënat e sakta, përpara fillimit të studimeve, me qëllim verifikimin e kushtit të sigurisë;
- dërgimin në Drejtorinë e Personelit në SHP, pas dërgimit nga AISM-ja dhe PU-ja, të listës përfundimtare të aplikantëve/kandidatëve fitues, sipas kuotave të miratuara;
- administrimin sipas rregullave të dokumentacionit të aplikantëve/kandidatëve që kanë marrë pjesë në konkurrim;
- përcaktimin e moshës maksimale të aplikantëve/kandidatëve që do të rekrutohen, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e ligjit 59/2014 “Për karrierën ushtarake në FARSH”, të ndryshuar dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të studimeve;
- përgatitjen dhe përmirësimin e testeve intelektual/psikologjik/fizik që përdoren për rekrutimin e aplikantëve/kandidatëve për oficerë;
- zhvillimin e testimit të gjuhëve të huaja me kandidatët që konkurrojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit;
- hartimin e kontratave në emër të Forcave të Armatosura me kandidatët, përpara fillimit të studimeve brenda ose jashtë vendit;
- përgatitjen e studentëve dhe kursantëve në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA;
- me përfundimin e studimeve, AFA-ja i propozon Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, titullim e studentëve dhe kursantëve oficerë dhe dërgon dokumentacionin e përfundimit të studimeve bachelor ose “Kursit të përgatitjes së oficerit të ri” në QPR, jo më vonë se 15 ditë nga përfundimi i tij.

dh) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU).

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU), sipas listës së kandidatëve të dërguar nga QPR-ja ose AFA-ja, në bashkëpunim me njëra-tjetrën dhe me struktura të tjera, bëjnë kontrollin e plotësimit të kushtit të sigurisë të kandidatëve për oficerë. Policia Ushtarake, gjithashtu, përgjigjet edhe për mbajtjen e rregullit, disiplinës dhe sigurimin e procesit të konkurrimit.

AISM-ja dhe PU-ja, të paktën 60 ditë para fillimit të studimeve, i dërgojnë QPR-së ose AFA-së, një përgjigje për plotësimin e kushtit të sigurisë të kandidatëve të përzgjedhur për oficerë.

Përgjigja për plotësimin e kushtit të sigurisë duhet të jetë në termat: “plotëson kushtin e sigurisë” ose “nuk plotëson kushtin e sigurisë”.

**e) Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së.**

QKMBM-ja bashkëpunon me QPR-në dhe AFA-në për publikimin e njoftimeve në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në organet e shtypit, në rrjetet sociale dhe në median audio-vizive, për mundësitë e ofruara për të drejtat e studimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë.

**ë) Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura (NJMU).**

NJMU-ja pranë Spitalit Universitar të Traumës përgjigjet për kryerjen e kontrollit fiziko-shëndetësor të shtetasve kandidatë për oficerë aktivë, të cilët janë shpallur fitues në përfundim të testeve, mbështetur në Rregulloren e Vlerësimit të Aftësive Fiziko-Shëndetësore të Shtetasit dhe Ushtarakut në Republikën e Shqipërisë, si dhe urdhrave e udhëzimeve të ministrit të Mbrojtjes për këtë qëllim.

**f) Batalioni i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.**

Batalioni i Shtabit të Përgjithshëm vë në dispozicion të AFA-së dhe QPR-së gjatë ditëve të testimit fizik një ambulancë dhe personelin mjekësor të nevojshëm dhe merr masa për futjen e kandidatëve në garnizon për kryerjen e testeve, duke bashkëpunuar me QPR-në dhe AFA-në.

**g) Inspektorati Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.**

Inspektorati Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, përpara fillimit të procesit të përzgjedhjes/konkursit institucional (testimit), nëpërmjet një përfaqësuesi, vlerëson raportet mjekësore për aftësi për studime të lëshuara nga mjeku i familjes dhe ekzaminimet biokimike dhe radiologjike të kryera në qendrat shëndetësore të vendbanimit.

**gj) Qendra e Automatizimit.**

Qendra e Automatizimit mbështet QPR-në dhe AFA-në në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, nëpërmjet Sistemit të Automatizuar, duke gjeneruar raportet e rezultateve të testeve.

**7. Zbatimi i politikës dhe procedurës së rekrutimit.**

Kjo politikë dhe procedurë mbështet realizimin e objektivave të përcaktuara nga SMBNJ 2020-2024, në fushën e rekrutimit të oficerëve, për një periudhë afatmesme. Zbatimi i saj është një proces kompleks dhe mund të kërkojë rishikimin e saj në varësi nga rrethanat dhe objektivat e përcaktuara. Ajo mban parasysh modelin e oficerit të ardhshëm të

Forcave të Armatosura Shqiptare, nevojat dhe burimet njerëzore, materiale dhe financiare të mundshme.

Për zbatimin e kësaj politike është i nevojshëm:

- planifikimi i nevojave të rekrutimit të kandidatëve për oficerë, të paktën për një periudhë 2-vjeçare, duke specifikuar burimin e rekrutimit dhe mundësitë e arsimimit;
- zhvillimi i marketingut, me qëllim sigurimin e burimeve dhe cilësisë së nevojshme;
- komunikimi i brendshëm, me synim nxitjen e ushtarëve/detarëve dhe nënoficerëve aktivë për të vazhduar karrierën në FA;
- mbështetja dhe krijimi i kushteve për ushtarët/detarët dhe nënoficerët aktivë që të vijojnë studimet e larta universitare gjatë shërbimit aktiv;
- vendosja e kontaktit me institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit të lartë për promovimin e vlerave të FA-së dhe për të inkurajuar të rinjtë për t'u bërë pjesë e Forcat e Armatosura.

## **8. Burimet e rekrutimit.**

Rekrutimi i kandidatëve për oficerë në FA do të jetë i larmishëm. Në raport me legjislacionin në fuqi, burimet e rekrutimit do të jenë:

- a) shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm të lartë brenda ose jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë që janë në vitin e fundit të arsimit të mesëm të lartë. Kjo kategori do të rekrutohet për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të vendeve të NATO-s dhe ato partnere, duke u bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimimit ushtarak;
- b) shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e lartë (minimumi bachelor) brenda ose jashtë vendit, të njësuar nga struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Kjo kategori do të rekrutohet për plotësimin e nevojave të FA-së me specialistë të kategorive të veçanta, si: jurist, ekonomist, financier, informatikë, topografi etj.;
- c) shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm të lartë brenda ose jashtë vendit të njësuar nga struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Kjo kategori do të rekrutohet për ndjekjen e studimeve bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura;
- ç) për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit ose në Akademinë e Forcave të Armatosura mund të konkurrojnë edhe ushtarët/detarët dhe nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji, kriteret e veçanta për çdo program studimi të miratuara nga Senati Akademik i AFA-së dhe nga ky dokument.

## **9. Instrumentet për matjen e efikasitetit të kësaj politike dhe procedure.**

Realizimi i kësaj politike duhet të jetë i matshëm dhe aktorët e përfshirë në proces duhet që të përshtatin masat e nevojshme, në mënyrë që kjo politikë të gjejë zbatim në mënyrë

efikase. Kjo shtron nevojën e përdorimit të instrumenteve të mëposhtme për matjen e efikasitetit:

- monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikës dhe procedurave për rekrutimin e oficerëve;
- analiza periodike e rekrutimit të oficerëve, duke krahasuar nevojat, standardet, procedurat e vendosura me personelin e rekrutuar;
- shpërndarja e pyetësorëve, me qëllim që të verifikohet niveli i plotësimit të kërkesave të rekrutimit;
- përcaktimi i të dhënave që mundësojnë matjen e efikasitetit të politikës dhe procedurave.

#### **10. Strukturat përgjegjëse për rekrutimin.**

- a) AFA-ja është struktura përgjegjëse për rekrutimin e kandidatëve për oficerë që do të ndjekin studimet e ciklit të parë bachelor dhe ciklit të dytë master në Akademinë e Forcave të Armatosura;
- b) Qendra e Personel-Rekrutimit është struktura përgjegjëse për rekrutimin e kandidatëve për oficerë që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe kandidatëve që do të ndjekin “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri”, në AFA (të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë, minimumi bachelor).

### **KREU II**

#### **PROCEDURA DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE PËR OFICERË**

##### **1. Të përgjithshme.**

- a) Pranimi për ndjekjen e studimeve në institucionet e larta arsimore, brenda ose jashtë vendit, do të bëhet me konkurrim dhe sipas nevojave të FA-së, ku kandidatët do t'i nënshtrohen testeve në disiplina të ndryshme;
- b) Nevojat e rekrutimit përcaktohen nga J-1, në muajin shtator të çdo viti, në bashkëpunim me forcat dhe strukturat e varësisë, për një periudhë 2-vjeçare. Në përcaktimin e nevojave për rekrutim mbahen në konsideratë mundësitë e arsimit brenda dhe jashtë vendit;
- c) Nevojat e rekrutimit, pas miratimit nga SHSHP-ja, i dërgohen DMBNJSH-së në Ministrinë e Mbrojtjes, J-1 në SHP, QPR-së dhe AFA-së;
- ç) QPR-ja, mbi bazën e planit të miratuar nga SHSHP-ja, programon punën për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet dhe strukturat e tjera;
- d) AFA-ja, mbi bazën e planit të arsimit të miratuar nga SHSHP-ja, miraton kuotat e pranimit për vitin akademik pasardhës dhe njofton institucionin përgjegjës për arsimin dhe QSHA-në.
- dh) AFA-ja, mbi bazën e planit të arsimit të miratuar nga SHSHP-ja dhe pas miratimit të kuotave nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, programon punën për

rekrutimin e kandidatëve për oficerë, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet dhe strukturat e tjera arsimore;

- e) publikimi i njoftimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë do të bëhet nga QKMBMM-ja, në bashkëpunim me DMBNJSH-në, AFA-në dhe QPR-në, në faqen e internetit të MM-së, në organet e shtypit, në median audio-vizive ose në rrjetet sociale.
- ë) publikimi i njoftimit për rekrutimin e kandidatëve/aplikantëve për oficerë në programet e ciklit të parë bachelor në AFA, do të bëhet nga faqja e AFA-ës, portali UAlbania dhe faqja e MM-së, në organet e shtypit, në median audio-vizive ose në rrjetet sociale;
- f) publikimi i njoftimit për rekrutimin e kandidatëve/aplikantëve ushtarakë apo civilë, brenda ose jashtë FA-së, do të bëhet nga faqja e AFA-së, portali Ualbania dhe faqja e MM-së, në organet e shtypit, në median audio-vizive ose në rrjetet sociale.

Njoftimi përmban:

- Programin e studimit apo kursin ose trajnimin;
- Numrin e kuotave të ofruara;
- Kriteret e pranimit;
- Mënyrën e aplikimit dhe afatet;
- Dokumentacionin e aplikimit për të gjitha fazat;
- Formatin e aplikimit në (Word);
- Llojin e konkursit që do të zhvillohet;
- Informacione të tjera të dobishme për kandidatët;
- Adresën e institucionit;

## **2. Kriteret e rekrutimit.**

### **2.1. Kriteret e përgjithshme.**

Kandidati që do të rekrutohet për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda ose jashtë vendit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- c) të mos jetë në ndjekje penale;
- ç) të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata;
- d) të mos ketë probleme me deportimin;
- dh) të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqes testet e kryera;
- e) të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale;
- ë) të plotësojë kriterin e moshës, sipas nenit 14, të ligjit 59/2014 “Për karrierën ushtarake në FARSH”, të ndryshuar;
- f) të ketë kryer arsimin përkatës;
- g) të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- gj) të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit;
- h) të jetë vlerësuar i aftë nga ana fiziko-shëndetësore nga NJMU-ja, pranë Spitalit Universitar të Traumës, për të shërbyer në Forcat e Armatosura;
- i) të plotësojë kushtin e sigurisë.

## **2.2. Kriteria specifike për rekrutimin e kandidatëve për oficerë për ndjekjen e studimeve të ciklit të parë bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura**

- a) të ketë kryer shkollën e mesme të lartë brenda ose jashtë vendit;
- b) të ketë notën mesatare të shkollës së mesme të lartë, në përputhje me germën “a”, pika 1 (jo më pak se 6.5), të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 3.6.2020, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe sipas vendimit të Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të programeve të ciklit të parë të studimeve në AFA;
- c) të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme) dhe të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike;
- ç) mosha e rekrutimit të kandidatëve/aplikantëve jo më pak se 18 dhe jo më shumë se 22 vjeç,
- d) të plotësojë kriteret e veçanta të pranimi të miratuara me vendim të Senatit Akademik

## **2.3. Kriteria specifike për rekrutimin e kandidatëve për oficerë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit**

- a) të ketë kryer shkollën e mesme të lartë ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentet e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit, duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Me përfundimin e studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave;
- b) të ketë notën mesatare të shkollës së mesme të lartë, jo më pak se 7 (shtatë) për ndjekjen e studimeve jashtë vendit;
- c) të plotësojë kriteret e veçanta të pranimi që lidhen me gjatësinë, peshën dhe moshën e kandidatëve, sipas specifikimeve të bëra nga vendet që ofrojnë të drejtat e studimit;
- ç) të mos jetë i martuar, kur një gjë e tillë është caktuar si kusht për pranimin në akademi nga vendet partnere;
- d) të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike;

- dh) të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në Shqipëri ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimin në akademi;
- e) kandidatët që do të aplikojnë për të konkurruar për ndjekjen e studimeve pranë akademive ushtarake të forcave dhe Fakultetin e Mjekësisë Gulhan, në Turqi, duhet të kenë përfunduar studimet e shkollës së mesme të lartë të të tria viteve me notën mesatare mbi 8 (tetë), lëndët matematikë, fizikë dhe kimi me notën mbi 8 (tetë) dhe provimet shtetërore të pjekurisë me notën mbi 8 (tetë);
- ë) kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e studimeve ushtarake në akademitë ushtarake në SHBA, duhet të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar dhe të folur dhe të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin e ALCPT-së. Ata duhet të jenë të regjistruar për zhvillimin e testeve online të TOEFL, SAT ose ACT, sipas Aneksit "C";
- f) kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e studimeve në shkollat ushtarake në Britaninë e Madhe dhe Qendrën e Studimeve Universitare në Kosovë duhet të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin ALCPT, ndërsa ata që konkurrojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake në Greqi duhet të sigurojnë minimumi 70 pikë në testimin ALCPT;
- g) kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
- kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit;
  - kanë qenë kontingjent i FA-së, për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda ose jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato;
- gj) kriteri i moshës së aplikimit specifikohet nga QPR-ja, duke pasur parasysh kriteret ligjore dhe kohëzgjatjen e studimeve. Në kohëzgjatjen e studimeve jashtë vendit të llogaritet edhe periudha e kursit të gjuhës së huaj, kur studimet paraprihen nga kursi i gjuhës (si në Greqi, Turqi dhe Itali);
- h) për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit mund të aplikohen edhe kriteret dhe teste specifike, si dhe ekzaminime shëndetësore shtesë, të cilat përcaktohen nga vendet pritëse si kriteret detyruese për pranimin në akademi. Në të tilla raste ato bëhen automatikisht pjesë e procedurës dhe kriterëve të rekrutimit, nëse nuk bien ndesh me kuadrin ligjor në fuqi.

#### **2.4. Kriteret për kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e "Kursit të përgatitjes së oficerit të ri".**

- a) të plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 2.1 dhe;
- b) në momentin e fillimit të kursit të plotësojnë moshën e lejuar për rekrutim, sipas ligjit 59/2014 "Për karrierën ushtarake në FA", të ndryshuar;
- c) të zotërojnë diplomën e arsimit të lartë (minimumi bachelor), të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të

Republikës së Shqipërisë dhe të kenë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë);

ç) të mos jenë të larguar nga puna në administratën qendrore ose vendore (nëse kanë qenë të punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.

## **2.5. Kriteret për kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve dhe nënoficerëve aktivë:**

- të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4;
- të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”;
- të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit.

2.6. Kandidatët që nuk plotësojnë qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5, nuk kualifikohen.

## **3. Procedura e aplikimit.**

3.1. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve për të ndjekur studimet e ciklit të parë bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura do të bëhet në *portalin UAlbania* [www.ualbania.al](http://www.ualbania.al)

3.2. Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit për programet e ciklit të parë në AFA, bëhen në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.10, datë 15.05.2019 “*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë, të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë*”, të ndryshuar; të urdhrat të përbashkët të QSHA-së dhe RASH-së për procesin e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë për çdo vit akademik” dhe këtë dokument.

3.3. Aplikimi për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe në Akademinë e Forcave të Armatosura nga shtetasit që kanë mbaruar arsimin e lartë, do të bëhet nëpërmjet faqes së internetit në adresën: [rekrutimi.qpr@aaf.mil.al](mailto:rekrutimi.qpr@aaf.mil.al). Kur kandidatët e kanë të pamundur ose të vështirë për të aplikuar online, ata mund të aplikojnë drejtpërdrejt në zyrën e pranimi të QPR-së, duke paraqitur edhe dokumentacionin sipas gërmës “a”, të pikës, 4.1, të kreut II të këtij dokumenti.

3.4. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t’ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat, brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës, lëshojnë një rekomandimin për QPR-në për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

3.5. Si rregull, procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike nga QPR-ja dhe AFA-ja në faqen e internetit të MM-së, të paktën 150 ditë përpara nga data e fillimit të studimeve dhe në raste të veçanta në momentin e marrjes së njoftimit.

## **4. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët.**

4.1. Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve jashtë vendit, duhet të

paraqesin në zyrën e pritjes së QPR-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Në fazën e aplikimit/regjistrimit:

- kërkesën me shkrim për ndjekjen e studimeve ushtarake, ku të specifikohet institucioni arsimor dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet;
- formularin me të dhëna personale, sipas formatit të përcaktuar në **Aneksin A**, bashkëlidhur dokumentit “Politika dhe procedura e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
- fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës, së bashku me listën e notave;
- fotokopje e kartës së identitetit;
- certifikatë familjare, 1 copë, e cila nxirret nëpërmjet sistemit, duke bashkëpunuar me DMBNJSH;
- fotografi për dokument (4x6), 2 copë;
- fotokopje të pasaportës, të vlefshme për jashtë shtetit;
- certifikatë për TOEFL, SAT ose ACT. Ky dokument kërkohet vetëm për kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e studimeve në shkollat e larta ushtarake në SHBA;
- formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore, i cili plotësohet pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, në fazën e regjistrimit, sipas **Aneksit B**, bashkëlidhur këtij dokumenti;
- formular i vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes ([www.mod.gov.al/bazaligjore](http://www.mod.gov.al/bazaligjore));
- raport mjekësor i aftë për kryerjen e studimeve, i lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike;
- ekzaminimet mjekësore për agentë infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- ekzaminime shëndetësore shtesë, të cilat përcaktohen nga vendet pritëse si kritere detyruese për pranimin në akademi.

b) Pas përfundimit të testimit.

Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 10 ditëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga përmbartimi;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- raportin mjekësor, së bashku me fletë ekzaminimet për agentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut, të lëshuar nga komisioni mjekësor ushtarak i Njësisë Mjekësore Ushtarake;

- për testet për lëndët narkotike të lëshuara nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e studimeve në shkollat e larta ushtarake në SHBA, do të plotësojnë formularin e historisë mjekësore "Form DD 2807-1 dhe formularin e ekzaminimeve mjekësore "Form DD 2808".

4.2. Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve të ciklit të parë bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, pasi janë renditur fitues në portalin UAlbania, raundi i parë, i dytë dhe i tretë, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë mësimore të AFA-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Faza e aplikimit për konkursin institucional:

- dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;
- fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftesë/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në QSHA;
- deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur udhëzimit të MASR nr. 10, nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë, të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësit të sekretarisë mësimore të AFA-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësi i sekretarisë (bashkëlidhur këtij dokumenti);
- kërkesën me shkrim;
- formularin me të dhëna personale, sipas formatit të përcaktuar në **Aneksin A**, bashkëlidhur këtij dokumenti;
- fotografi për dokument (4x6), 2 copë;
- certifikatë familjare, 1 copë;
- formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore, i cili plotësohet pranë Sekretarisë së AFA-së, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, sipas **Aneksit B**, bashkëlidhur këtij dokumenti;
- formular i vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes ([www.mod.gov.al/baza\\_ligjore](http://www.mod.gov.al/baza_ligjore));
- raport mjekësor i aftë për studime, lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohej se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike;
- ekzaminimet mjekësore për agjentë infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndë narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndë narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

b) Faza e regjistrimit:

- Në përfundim të konkursit institucional dhe kontrollit shëndetësor aplikantët/kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda afatit kohor të

përcaktuar në kalendarin për procedurat e aplikimit në programet e ciklit të parë të studimeve, miratuar me urdhër të QSHA-së dhe RASH-së, pas shpalljes së tyre fitues në portalin [www.ualbania.al](http://www.ualbania.al), mund të kryejnë procesin e regjistrimit pranë Sekretarisë mësimore të AFA-së, ku njëkohësisht duhet të dorëzojnë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- vërtetim nga përmbartimi;

4.3. Qendra e Personel-Rekrutimit dhe AFA-ja vijojnë procedurat e testimit dhe përzgjedhjes vetëm me kandidatët të cilët kanë paraqitur dokumentacionin sipas pikës 4.1.

4.4. Aplikantët, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të MM-së, si dhe në zyrën e regjistrimit në QPR-së dhe Sekretarisë mësimore të AFA-së, njihen edhe me:

- tabelat e normave fizike (**Aneksi E**);
- fazat, procedurën dhe dokumentacionin e aplikimit/ konkurrimit;
- mënyrën e zhvillimit të testimit të pranimi;
- tabelën e normave fizike për pranim në akademitë ushtarake në SHBA, sipas **Aneksit E1**, bashkëlidhur këtij dokumenti. Kjo tabelë i jepet vetëm kandidatëve që aplikojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake në Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- tabelën e normave fizike për pranimin në akademitë ushtarake në Itali, Turqi, Greqi, Britaninë e Madhe etj., sipas kërkesave specifike të vendeve përkatëse (kur aplikohen disiplina dhe testime fizike të ndryshme nga aneksi E);
- tabelën me të dhëna për zhvillimin e testimeve të gjuhës angleze SAT, ACT dhe TOEFL, sipas **Aneksit C**, bashkëlidhur këtij dokumenti. Ky dokument i jepet vetëm kandidatëve që aplikojnë për ndjekjen e studimeve në shkollat e larta ushtarake në SHBA;
- mënyrën e trajtimit të tyre gjatë studimeve jashtë vendit në lidhje me udhëtimin, akomodimin, ushqimin, siguracionin shëndetësor, trajtimin financiar etj.;
- çdo informacion tjetër të nevojshëm që ka lidhje me konkurrimin, ndjekjen e studimeve dhe karrierën në FA.

4.5. Kandidatët që përzgjidhen për ndjekjen e studimeve në SHBA, paraqesin pranë zyrës së pritjes së QPR-së edhe formularët mjekësorë "**Form DD 2807-1 dhe Form DD 2808**", bashkëlidhur këtij dokumenti, të cilët do të përdoren nga aplikanti për t'iu nënshtruar vlerësimit të gjendjes së tij shëndetësore në komisionin mjekoligjor.

## 5. Komunikimi me kandidatët.

- a) Njoftimi i kandidatëve për datën dhe mënyrën e zhvillimit të testimeve, si dhe rregullat e menaxhimit të procesit përcaktohen nga QPR-ja dhe AFA-ja, të cilat bëhen publike në faqen e internetit të MM-së;

- b) Pas aplikimit, komunikimet me karakter kolektiv do të publikohen në faqen e internetit të MM-së, ndërsa ato me karakter personal do të bëhen të ditura nëpërmjet telefonit ose adresës personale të email-it të secilit. Këto komunikime kanë karakter njoftimi me të gjitha efektet.

## 6. Zhvillimi i konkurrimit.

- a) Me kandidatët që do të ndjekin studimet bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, zhvillimi i konkurrimit institucional përfshin:

- ekzaminimet mjekësore;
- testimin fizik;
- intervistën e pranimit dhe vlerësimin psikologjik;
- testin intelektual.

- b) Me kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët që do të ndjekin KPO të ri në AFA, zhvillimi i konkurrimit përfshin:

- ekzaminimet mjekësore;
- testimin fizik;
- testimin intelektual;
- testimin e gjuhës angleze ose gjuhëve të tjera të huaja;
- testimin psikologjik.

- c) Sasia maksimale e pikëve që kandidati mund të marrë gjatë konkurrimit është 100;

- ç) Ndarja e pikëve sipas disiplinave të testimit për kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe kandidatët që do të ndjekin KPO të ri në AFA (kandidatët që do të rekrutohen nga shtetasit që kanë përfunduar arsimin e lartë), është sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndjekja e studimeve në AFA dhe në akademitë ushtarake jashtë vendit                | Pikët maksimale që kandidati mund të marrë për vlerësimin e diplomës dhe në çdo disiplinë të testimit |                            |                                  |                                        |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|----------------------------------|----------------------------------------|
|     |                                                                                    | Vlerësimi i diplomës                                                                                  | Vlerësimi i testimit fizik | Vlerësimi i testimit intelektual | Vlerësimi i testimit të gjuhës së huaj |
| 1.  | Rekrutimi për ndjekjen e KPO të ri në AFA (me arsim të lartë)                      | 30                                                                                                    | 25                         | 25                               | 20                                     |
| 2.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në SHBA, Britani e Madhe dhe Kosovë             | 30                                                                                                    | 25                         | 20                               | 25                                     |
| 3.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në Turqi, Itali dhe Greqi                       | 30                                                                                                    | 25                         | 20                               | 25                                     |
| 4.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në fushën e mjekësisë në Turqi, Greqi dhe Itali | 40                                                                                                    | 15                         | 20                               | 25                                     |

- d) Formula e llogaritjes së pikëve të konkursit të pranimit në AFA për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor, të jetë si më poshtë:

|            |                                                             |            |
|------------|-------------------------------------------------------------|------------|
| <b>P</b>   | Pikët e përgjithshme për konkurrim:                         | 100 totali |
| <b>MNP</b> | Nota mesatare e përgjithshme ose 40 % e totalit të pikëve:  | 40 pikë    |
| <b>PK</b>  | Pikët e konkursit të pranimit ose 60 % e totalit të pikëve: | 60 pikë    |

- e) Ndarja e pikëve sipas disiplinave të testimit për kandidatët **PK** që do të ndjekin studimet bachelor na AFA është si më poshtë:

- intervista e pranimit dhe vlerësimi psikologjik; 30 pikë;
- testimit fizik, 20 pikë;
- testi intelektual, 10 pikë;

Formula e llogaritjes së pikëve:  $P = (NMP \ 40 \times 0.4 + PK / 60 \times 0.6 \times 100)$

Minimumi i pikëve për pranimin e konkurrentëve në programin e studimeve të ciklit të parë bachelor është 40 pikë.

#### **7. Komisionet e testimit dhe përbërja e tyre.**

- a) Për vlerësimin e kandidatëve që do të ndjekin studimet bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura caktohen komisionet pranë Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) ofrojnë këto programe, si më poshtë:

- Komisioni i intervistës së pranimit dhe vlerësimit psikologjik;
- Komisioni për ekzaminimin mjekësor (NJMU);
- Komisioni i testimit fizik;
- Komisioni i testimit intelektual;
- Komisioni i ankimit.

- b) Për vlerësimin e kandidatëve që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët që do të ndjekin KPO të ri në AFA, caktohen komisionet e mëposhtme:

- Komisioni për vlerësimin e testimit fizik;
- Komisioni për testimin intelektual;
- Komisioni për vlerësimin e testimit psikologjik;
- Komisioni për vlerësimin e njohurive në gjuhët e huaja;
- Komisioni për ekzaminimin mjekësor.

- c) Komisionet përbëhen nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë dhe miratohen me urdhër të SHSHP, sipas propozimeve të rektorit të AFA-së/komandantit të QPR-së;

- ç) Përbërja e komisionit të testimit të njohurive në gjuhët e huaja dhe ekzaminimit mjekësor përcaktohet nga drejtuesit e QGJH-së dhe Njësisë Mjekësore Ushtarake, sipas rregulloreve të brendshme të tyre;

- d) Për vlerësimin e kandidatëve që do të ndjekin studimet bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Komisioni për intervistën e pranimit do të kryejë edhe detyrën e Komisionit qendror të vlerësimit, i cili, përveçse do të organizojë, do të ndjekë dhe do të vlerësojë kandidatët në intervistën e pranimit, do të administrojë rezultatet e testimit fizik, do të llogarisë pikët maksimale për çdo kandidat dhe do të hartojë edhe listën finale të meritës. Psikologu, anëtar i Komisionit të intervistës së pranimit dhe vlerësimit psikologjik, nuk bën vlerësim me pikë, por vetëm “kalon” apo “nuk kalon”. Kandidatët që vlerësohen me “nuk kalon” në vlerësimin psikologjik, nuk kanë të drejtë të aplikojnë serish për t’u bërë pjesë e FA-së në vitet e ardhshme.
- dh) Për vlerësimin e kandidatëve që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët që do të ndjekin KPO të ri në AFA, Komisioni intelektual do të kryejë edhe detyrën e Komisionit qendror të vlerësimit, i cili, përveçse do të organizojë, do të ndjekë dhe vlerësojë kandidatët në testimin intelektual, do të administrojë rezultatet e testimit fizik, psikologjik dhe të gjuhës së huaj, do të llogarisë pikët maksimale për çdo kandidat dhe do të hartojë listën e rezultateve përfundimtare të kandidatëve (listën e meritës);
- e) Për zhvillimin e testeve, kur është e nevojshme, QPR-ja/AFA-ja i kërkon SHPFA-së që t’i mbështesë me personel dhe specialistë të disiplinave të ndryshme.

## 8. Testimi fizik.

- a) Testimi fizik është hapi i parë i konkurrimit. Ai ka si qëllim të verifikojë standardet fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t’u rekrutuar si oficerë në FARSH. Kandidati lejohet të marrë pjesë në testimin fizik vetëm nëse është i aftë nga ana fiziko-shëndetësore, e vërtetuar me raportin mjekoligjor të lëshuar nga komisioni përkatës;
- b) Kandidatët i nënshtrohen testimit fizik në tri disiplinat e mëposhtme:
- vrapim 1000 m;
  - ulje-ngritje mbi krahë (pompa);
  - palosje-shpalosje;
- c) Testimi fizik zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të testimit fizik, sipas normave të përcaktuara në Aneksin E, bashkëlidhur këtij dokumenti;
- ç) Për kandidatët që do të ndjekin studimet ushtarake në akademitë ushtarake jashtë vendit mund të aplikohen standarde të ndryshme fizike për peshën, gjatësinë, disiplinat dhe normat e testimit, të cilat përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh dhe konsiderohen në mënyrë automatike pjesë e procedurës dhe kriterëve të përzgjedhjes. Për kandidatët që konkurrojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake në SHBA, testimi fizik zhvillohet sipas disiplinave dhe normave të përcaktuara në Aneksin E1, bashkëlidhur këtij dokumenti;
- d) Testimi fizik zhvillohet në prani të ambulancës dhe ekipit mjekësor;

- dh) Në testin fizik kandidati duhet të paraqitet me veshje sportive të siguruara prej tij (bluzë e pantallona të shkurtra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete);
- e) Testimi zhvillohet në disa sesione dhe për një ose disa ditë, në varësi nga numri i kokurrentëve. Pas çdo sesioni të testimit fizik, kandidatët listohen sipas pikëve, duke filluar nga ai që ka marrë më shumë pikë. Listat e rezultateve, pasi firmosen nga kryetari dhe anëtarët e komisionit, i dërgohen Komisionit qendror. Rezultatet e testimit hidhen brenda ditës në Sistemin e Automatizuar të Burimeve Njerëzore nga komisioni përkatës i testimit dhe u bëhen të ditura kandidatëve;
- ë) Kandidati duhet të marrë minimumi 60 pikë për çdo disiplinë të përgatitjes fizike, për të vijuar konkurrimin e mëtejshëm;
- f) Pas përfundimit të testimit fizik, nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore, gjenerohet “Raporti i rezultateve të testimit fizik”. Raporti përmban: numrin, emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, gjatësinë, gjininë (mashkull ose femër), disiplinat e testimit, normat e arritura dhe sasinë e pikëve për çdo disiplinë, pikët totale të marra në testimin fizik, si dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit fizik “kalues” ose “mbetës”. Raporti firmoset nga kryetari dhe anëtarët e komisionit, ngritur pranë AFA-së /QPR-së dhe komandanti i QPR-së.
- g) Kandidatët që rezultojnë “mbetës” në testimin fizik ndërpresin konkurrimin e mëtejshëm;
- gj) Llogaritja e pikëve të siguruara nga testimi fizik bëhet sipas Aneksit “D”, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij dokumenti.

## 9. Testimi intelektual.

- a) Testimi intelektual do të zhvillohet me kandidatët që rezultojnë kalues në testin fizik. Ai do të zhvillohet me kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët që do të ndjekin programet e ciklit të parë bachelor, si dhe me ata që do ndjekin KPO të ri në AFA. Nëpërmjet tij do të vlerësohet niveli i njohurive dhe kulturës së përgjithshme, aftësitë për të gjykuar dhe vepruar, aftësitë e përqendrimit të vëmendjes, si dhe niveli i përgjithshëm i inteligjencës.
- b) Testimi intelektual do të zhvillohet në fushat:
- logjika matematike;
  - njohja e kuptimit të fjalëve;
  - të kuptuarit e paragrafëve;
  - njohuri matematikore;
  - njohuri të kulturës së përgjithshme;
- c) Në testimin intelektual, minimumi i pikëve që kandidatët duhet të marrin është 95 pikë (nga 155 të mundshme);
- ç) Kandidati që nuk arrin minimumin e pikëve, skualifikohet, duke ndërprerë konkurrimin e mëtejshëm;

- d) Testi intelektual përgatitet në dy e më shumë versione dhe administrohet nga QPR-ja. Testi intelektual është i njëjtë për të gjithë kandidatët. Për programet e ciklit të parë QPR-ja bashkëpunon me AFA-në për zhvillimin e këtij testi me kandidatët/maturantët që konkurrojnë në një nga programet e ciklit të parë bachelor në AFA.
- dh) Zhvillimi dhe vlerësimi i testimit do të bëhet në kompjuter nën mbikëqyrjen e Komisionit të testimit intelektual;
- e) Gjatë zhvillimit të testimit intelektual, nuk lejohet përdorimi i celularit, tabletave ose pajisjeve të tjera elektronike. Mosrespektimi i këtyre rregullave sjell përjashtimin nga konkurrimi;
- ë) Vlerësimi i çdo kandidati dhe kualifikimi i tij bëhet automatikisht nëpërmjet sistemit. Në përfundim të testimit, sistemi (kompjuteri) gjeneron për çdo kandidat sasinë e pikëve dhe konfirmon nëse kandidati është kualifikuar ose jo (kalon ose nuk kalon);
- f) Në përfundim të testimit intelektual, nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore, gjenerohet “Raporti i rezultateve të testimit intelektual”, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe i përcillet komandantit të QPR-së/rektorit të AFA-së. Kandidatët listohen sipas pikëve, duke filluar nga ai që ka siguruar më shumë pikë;
- g) Pesha që ka testimi intelektual në vlerësimin e përgjithshëm dhe llogaritja e pikëve jepet në Aneksin D, bashkëlidhur këtij dokumenti.

#### 10. Testimi psikologjik.

- a) Testimi psikologjik zhvillohet me qëllim që të vlerësohet te kandidati përgjegjshmëria, motivimi, aftësia për të menduar dhe gjykuar, si dhe qëndrueshmëria e sjelljes. Gjithashtu, ai ka si synim që t’u jepet përparësi atyre individëve që janë të motivuar për t’i shërbyer vendit si oficerë aktivë kudo që e kërkojnë misionet dhe detyrat e Forcave të Armatosura dhe mundësisht të përcaktojnë edhe prirjet e tyre. Ai zhvillohet si disiplinë testimi më vete me kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët dhe KPO.
- b) Testimi psikologjik zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të testimit psikologjik;
- c) Testimi psikologjik zhvillohet në formë interviste dhe është skualifikues. Në çdo rast, arsyet e skualifikimit të kandidatëve motivohen me shkrim;
- ç) Në përfundim të testimit psikologjik, komisioni përkatës i dërgon komandantit të QPR-së “Raportin e rezultateve të testimit psikologjik”. Raporti gjenerohet nga sistemi dhe përmban: nr., emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, rezultatet e testimit psikologjik dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit psikologjik “kalon” ose “nuk kalon”;
- d) Kandidatët që vlerësohen me “nuk kalon” në testimin psikologjik, nuk kanë të drejtë të aplikojnë sërish për t’u bërë pjesë e FA-së në vitet e ardhshme.

#### 11. Testimi në gjuhën e huaj.

- a) Testimi në gjuhën e huaj do të bëhet me qëllim që të verifikohet niveli i njohjes së gjuhëve të huaja. Ai përfshin testimin në gjuhën angleze dhe testimin në gjuhën e vendit, ku kandidati do të ndjekë studimet ushtarake;
- b) QGJH është përgjegjëse për zhvillimin e testimit të gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të huaja;
- c) Gjuha e huaj, standardi që do të aplikohet për testimin e kandidatëve dhe minimumi i nevojshëm i pikëve që kandidati duhet të marrë, përcaktohen nëpërmjet kushteve të pranimit nga pala që ofron të drejtën e studimit;
- ç) Kandidati që nuk arrin nivelin e kërkuar të njohjes së gjuhës së vendit ku do të arsimohet, sipas marrëveshjes dypalëshe, skualifikohet. Testimi do të zhvillohet në bashkëpunim me përfaqësuesin ushtarak të vendit përkatës, kur një gjë e tillë kërkohet nga ana e tyre;
- d) Kandidatët që do të ndjekin studimet në SHBA, Britaninë e Madhe dhe Kosovë do të testohen në gjuhën angleze sipas ELPT-së dhe duhet të marrin minimumi 75 pikë që të kualifikohen, ndërsa ata që do të testohen për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake në Greqi duhet të marrin minimumi 60 pikë që të kualifikohen;
- dh) Kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake në Itali, do të testohen në QGJH në gjuhën italiane sipas ALCPT-së. Minimumi i pikëve që kandidatët duhet të marrin është 46 nga 100 të mundshme;
- e) Kandidatët që do të ndjekin “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri” në AFA do të testohen në gjuhën angleze sipas ELPT-së;
- ë) Kandidatët që do të konkurrojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit, në qoftë se nuk testohen në gjuhën e vendit ku do të studiojnë, duhet t’i nënshtrihen testit të gjuhës angleze. Rezultatet e testimit të gjuhës angleze merren parasysh në rankimin përfundimtar të kandidatëve;
- f) Në përfundim të testimit, drejtori i QGJH-së i paraqet Komisionit të testimit intelektual rezultatet e testimit të gjuhës angleze ose të gjuhëve tjera të huaja, kur ato kërkohen, me shkrim dhe në mënyrë elektronike;
- g) Komisioni përkatës hedh në Sistemin e Automatizuar të Burimeve Njerëzore rezultatet e testimit të gjuhëve të huaja dhe nëpërmjet sistemit gjeneron “Raportin e rezultateve të testimit të gjuhës së huaj”, i cili, pasi firmoset nga komisioni, i përcillet komandantit të KDS-ë /QPR-së;
- gj) Pësja që ka gjuha e huaj në vlerësimin e përgjithshëm dhe llogaritja e pikëve të gjuhës së huaj jepet në pikën 6 dhe 7 të Aneksit D, bashkëlidhur këtij dokumenti.

## **12. Intervista e pranimit dhe vlerësimi psikologjik.**

- a) Qëllimi i intervistës së pranimit është që të vlerësojë njohuritë e përgjithshme kulturore, njohuritë mbi Forcat e Armatosura, shkallën e motivimit dhe aftësinë për të menduar e gjykuar, si dhe qëndrueshmërinë e sjelljes së kandidatëve, punës në grup.

- b) Intervista zhvillohet nën mbikëqyrjen e komisionit përkatës, i cili caktohet me propozim të rektorit/komandantit të AFA-së dhe miratohet me urdhër të SHSHPPFA-së. Komisioni përbëhet nga minimumi 3 anëtarë (1 nga AFA, 1 nga MM, 1 nga SHPPFA), 1 psikolog dhe 1 sekretar. Kryetar caktohet një oficer me gradën kolonel nga AFA-ja.
- c) Intervista zhvillohet me gojë, sipas pyetjeve të miratuara nga Senati Akademik i AFA- së. Ajo fillon me vetëprezantimin dhe më pas vazhdon me pyetje-përgjigje të kandidatëve/aplikantëve. Nëpërmjet vetëprezantimit synohet të merret më shumë informacion mbi kandidatin në lidhje me studimet e kryera, prirjet e tij dhe motivimin për t'u bërë pjesëtar i Forcave të Armatosura dhe punës në situata stresi me ngarkesë psikologjike emocionale.

Përmbajtja e pyetjeve lidhet me njohuritë mbi FA-në, motivin, sjelljen, aftësinë për të gjykuar e vepruar.

Rubrikat e pyetjeve janë sipas fushave të mëposhtme:

- ✓ Pyetje në lidhje me motivimin ;
- ✓ Pyetje në lidhje me integritetin ;
- ✓ Pyetje në lidhje me vetëvlerësimin ;
- ✓ Pyetje mbi aftësitë për të punuar në grup ;
- ✓ Pyetje në lidhje me aftësinë për të punuar nën stres dhe presion .

Gjatë zhvillimit të intervistës nuk bëhen pyetje në lidhje me moshën, gjendjen civile, familjare, preferencat fetare, politike, etj.

ç) Intervista zhvillohet, si më poshtë:

Kryetari prezanton anëtarët e komisionit dhe i shpjegon kandidatit që intervistohet mënyrën se si do të zhvillohet intervista.

Sasia e pyetjeve që do t'i bëhen kandidatit është 6 (gjashtë).

- ✓ P1- 6 pikë
- ✓ P2- 6 pikë
- ✓ P3- 6 pikë
- ✓ P4- 6 pikë
- ✓ P5- 6 pikë

Secili prej anëtarëve vlerëson çdo pyetje me pikë, sipas sistemit nga 1-6 pikë.

d) Vlerësimi i kandidatëve për intervistën nga çdo anëtar do të bëhet nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore.

dh) Llogaritja e pikëve të siguruara nga intervista bëhet sipas formulës në pikën 6, germa "d".

- e) Në përfundim të procesit të vlerësimit, Sistemi i Automatizuar i Burimeve Njerëzore, gjeneron "Listë meritën e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim", e cila firmoset nga kryetari dhe anëtarët e komisionit dhe i dërgohet rektorit/komandantit të AFA-së. Listë merita përmban: emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, rezultatet e vlerësimit për diplomën, rezultatet e testimit fizik, rezultatet e testimit intelektual dhe rezultatet e intervistës së pranimit, sasinë e përgjithshme të pikëve të siguruara nga kandidatët dhe rankimin e tyre, sipas pikës 6, germa "d" dhe "e".

### **13. Shpallja e rezultateve paraprake.**

- a) Pas përfundimit të testeve dhe hedhjes të të dhënave në SAMBNJ, nëpërmjet sistemit, gjenerohet "Raporti i rezultateve paraprake të testimit të kandidatëve", i cili firmoset nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit qendror dhe i përcillet komandantit të QPR-së/rektorit të AFA-së. Rezultatet paraprake marrin në konsideratë të gjitha pikët e siguruara nga zhvillimi i testeve. Mënyra e llogaritjes së pikëve jepet në Aneksin D;
- b) Mbi bazën e listës së rezultateve të dërguar nga Komisioni qendror, rektori i AFA-së/komandanti i QPR-së bën shpalljen e rezultateve paraprake të testimit, të cilat afishohen në një vend të dukshëm pranë AFA/QPR-së;
- c) Për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake në Turqi dhe Greqi, kur kandidatët kanë aplikuar si alternativë të parë ndjekjen e studimeve në mjekësi dhe si alternativë të dytë ndjekjen e studimeve në akademitë e FT-së, FA-së ose FD-së, listimi i kandidatëve, sipas pikëve të siguruara, do të bëhet në dy lista: njëra për ndjekjen e studimeve në mjekësi dhe tjetra për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake të FT-së, FD-së ose FAj.

### **14. Ankimimi.**

- a) Me shpalljen e rezultateve paraprake, kandidatët që nuk janë dakord me rezultatet, kanë të drejtë të ankohen me shkrim pranë komandantit të QPR-së. Ankimimi bëhet brenda 24 orëve nga përfundimi i testimit. Shqyrtimi i ankesave bëhet brenda 2 ditëve nga marrja e ankesës;
- b) Për programet e ciklit të parë të studimeve bachelor në AFA, aplikantët /kandidatët kanë të drejtën e ankimit pranë AFA-së në datën përkatëse të raundit të parë, të dytë dhe të tretë, sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-së, për çdo vit akademik;
- c) Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, AFA-ja duhet të shprehet me vendim lidhur me ankimet. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik, në portalin UAlbania, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-së, për çdo vit akademik;
- ç) Vendimet e IAL-ve ankohen në gjykatën kompetente;
- d) Shqyrtimi i ankesave do të bëhet nga Komisioni i ankimit, i cili ngrihet me urdhër të SHSHPFA-së dhe përbëhet nga:

- një oficer me gradën “nënkolonel”, përfaqësues i J-1, kryetar;
- një oficer me gradën “nënkolonel”, përfaqësues i AFA-së, anëtar;
- një oficer me gradën “major-nënkolonel”, përfaqësues i QPR-së, anëtar;
- një nënoficer i QPR-së me gradën “kapter”, sekretar;

dh) Për programet e ciklit të parë bachelor, shqyrtimi i ankesave do të bëhet nga Komisioni i ankimimit, i cili ngrihet me urdhër të SHSHPPFA-së, sipas propozimit të rektorit të AFA-së dhe përbëhet nga:

- një oficer me gradën “kolonel” ose civil ekuivalent, përfaqësues i AFA-së, kryetar;
- një oficer me gradën “nënkolonel” ose civil ekuivalent, përfaqësues i AFA-së;
- një oficer me gradën “nënkolonel”, përfaqësues i J-1, anëtar;
- një oficer me gradën “major-nënkolonel”, përfaqësues i QPR-së, anëtar;
- një nënoficer i AFA-së me gradën “kapter”, sekretar;

Ky komision ngrihet para fillimit të procedurave të aplikimit të raundit të parë dhe funksionon deri në përfundim të raundit të tretë.

- a) Kur komisioni i ankimimit konstaton se ankesa është e bazuar, mund të kërkojë ritestimin e kandidatëve. Pas ritestimit përditësohet lista e rezultateve paraprake të konkurrimit. Për programet e ciklit të parë bachelor ritestimi duhet bërë sipas datave dhe afateve të përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-së, për çdo vit akademik.

#### **15. Shpallja e rezultateve përfundimtare të testimit.**

- a) Për aplikantët që konkurrojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe në “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri”, në AFA, shpallja e rezultateve përfundimtarë bëhet pas marrjes në shqyrtim të ankesave, por jo më vonë se 90 ditë nga fillimi i studimeve;
- b) Për programet e ciklit të parë bachelor shpallja e rezultateve përfundimtare bëhet brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-së, për çdo vit akademik.
- c) Lista e rezultateve përfundimtare të testimit, e cila gjenerohet nëpërmjet SAMBNJ nga Komisioni intelektual/Komisioni i intervistës së pranimit, i përcillet komandantit të QPR-së/rektorit të AFA-së, me shkrim dhe në formatin elektronik. Koordinator i AFA-së ngarkon listën e kandidatëve fitues në portalin UAlbania.
- ç) Komandanti i QPR-së/rektori i AFA-së bën shpalljen e rezultateve të konkurrimit në një vend të dukshëm dhe në faqen e internetit të MM-së/AFA-së dhe i përcjellë listën e fituesve AISM-së dhe PU-së, për verifikimin e plotësimit të kushtit të sigurisë.

#### **16. Ekzaminimi mjekësor pranë NJMU-së.**

- a) Brenda 24 orëve nga nxjerrja e rezultateve përfundimtare, komandanti i QPR-së i dërgon drejtorit të NJMU-së, pranë SUT, listën e kandidatëve për kryerjen e ekzaminimeve të nevojshme mjekësore;

b) Ekzaminimi mjekësor bëhet në bazë të “Rregullores së vlerësimit të aftësive fiziko-shëndetësore të shtetasve dhe ushtarëve të FA-së”, të miratuar me urdhër të MM-së nr. 381, datë 09.07.2004 dhe urdhrit të ministrit të Shëndetësisë nr. 2253, datë 17.06.2004.

c) Ekzaminimi mjekësor përfshin:

- këqyrjen fizike;
- ekzaminimin e përgjithshëm;
- vizitë okulisti;
- vizitë kardiologu;
- vizitë neurologu;
- vizitë psikiatri;
- vizitë psikologu;
- vizitë kirurgu;
- vizitë ortopedi;
- vizitë alergologu;
- vizitë endokrinologu;
- vizitë infeksionisti;
- vizitë gastrohepatologu;
- vizitë hematologu;
- vizitë ORL;
- vizitë pneumologu;

ç) Në rast se specialistët mjekë dhe/ose anëtarët e komisionit të NJMU-së e gjykojnë të nevojshme mund të kërkojnë për kandidatët ekzaminime të tjera shtesë:

- biokimike;
- për alergjenë të ndryshëm;
- të urinës;
- grupin e gjakut
  - Rezus
  - Agjentë infektivë
  - HBSAg;
  - Anti HCV;
  - HIV;
  - Testi i Sifilizit
  - Testi për lëndë narkotike

d) Për aplikantët që konkurrojnë për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe në “Kursin e përgatitjes së oficerit të ri”, në AFA, ekzaminimet mjekësore kryhen brenda 10 ditëve nga dërgimi i listës së kandidatëve nga ana e komandantit të QPR-së. Për programet e ciklit të parë bachelor ekzaminimet mjekësore kryen në datat dhe afatet e përcaktuara nga rektori i AFA-së, bazuar në udhëzimin dhe afatet e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-së, për çdo vit akademik.

dh) Në përfundim të ekzaminimeve të kryera, Komisioni mjekësor vendos nëse kandidati është i aftë për të shërbyer në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose jo. Kandidatët që rezultojnë të paafët nga ana shëndetësore skualifikohen;

- e) Për programin e ciklit të parë bachelor ekzaminimi mjekësor kryhet i pari, i ndjekur nga testimi fizik dhe testimi intelektual. Kryetari i komisionit, në përfundim të çdo ekzaminimi mjekësor, kur kandidati rezulton i paaftë njofton kandidatin për paaftësinë dhe i dërgon kryetarit të Komisionit të testimit fizik në rrugë elektronike (email, sms) ose me shkrim emrin dhe mbiemrin e këtij kandidati për ta përjashtuar nga testimi fizik. Në përfundim të procesit të ekzaminimit mjekësor, i dërgon brenda 24 orëve rektorit/komandantit të AFA-së, raportin dhe dokumentacionin përkatës për të gjithë aplikantët e ekzaminuar.
- ë) Brenda 24 orëve nga përfundimi i ekzaminimit mjekësor, drejtori i NJMU-së pranë Spitalit Universitar të Traumës, i dërgon në rrugë elektronike dhe me shkrim komandantit të QPR-së rezultatet e ekzaminimeve mjekësore;
- f) Rezultatet e ekzaminimeve mjekësore hidhen nga komisioni përkatës në Sistemin e Automatizuar të Burimeve Njerëzore;
- g) Përpos, NJMU-ja mund të kryejë edhe ekzaminime të tjera specifike, të cilat nuk përfshihen në germën “b” dhe “c”, të pikës 16, kur ato kërkohen dhe janë të nevojshme për pranimin në akademitë ushtarake të vendeve të tjera;
- gj) Për kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake në SHBA, bashkë me raportin mjekoligjor, që vërteton aftësinë shëndetësore për të vijuar studimet ushtarake, kryetari i Komisionit mjekoligjor dhe kandidati duhet të nënshkruajnë deklaratën mjekësore në gjuhën angleze për akademinë ose akademitë që kandidati ka përzgjedhur të kandidojë, sipas formateve në Aneksin F, bashkëlidhur në këtij dokumenti.

#### **17. Verifikimi i plotësimit të kushtit të sigurisë.**

- a) AISM-ja dhe Policia Ushtarake kryejnë verifikimet e nevojshme, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me strukturat e tjera të tjera të zbatimit të ligjit dhe kthejnë përgjigje, si rregull, jo më vonë se 60 ditë para nga fillimi i studimeve. Përgjigja duhet të jetë “Plotëson kushtin e sigurisë” ose “Nuk plotëson kushtin e sigurisë”;
- b) Për kandidatët që do të ndjekin studimet bachelor në AFA, periudha e verifikimit të kushtit të sigurisë mund të jetë më e shkurtër se zakonisht dhe përcaktohet nga kalendari i miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-së, për çdo vit akademik.

#### **18. Procedurat pas verifikimit të kushtit të sigurisë.**

- a) Brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e rezultateve të verifikimit të kushtit të sigurisë nga AISM-ja dhe PU-ja, QPR-ja/AFA-ja i përcjellin J-1, listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, me qëllim që kjo e fundit të ndjekë procedurat për miratimin e kandidatëve nga SHSHP të FA-së;
- b) Brenda 2 (dy ditëve) nga marrja e listës përfundimtare të kandidatëve fitues, J-1 i përcjell për miratim SHSHP kandidatët fitues;

- c) Brenda 24 orëve nga miratimi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, lista e kandidatëve, nëpërmjet J-1, i përcillet shkresërisht dhe në rrugë elektronike DMBNJSH-së, për vijimin e procedurave të mëtejshme;
- ç) DMBNJSH-ja, brenda 2 (dy) ditëve, ia përcjell listën e kandidatëve të kualifikuar, së bashku me rezultatet përfundimtare të testimit, ministrit të Mbrojtjes i cili përzgjedh kandidaturat fituese. Miratimi paraprak i kandidaturave nga ministri, si rregull bëhet jo më vonë se 50 ditë para nga fillimi i studimeve. Për programet e ciklit të parë bachelor, në përfundim të procedurave të regjistrimit të kandidatëve fitues, ministri i Mbrojtjes miraton me urdhër kandidaturat fituese (sipas kuotave të miratuara ), para fillimit të vitit akademik.
- d) Pas miratimit paraprak të kandidatëve nga ministri i Mbrojtjes, DMBNJSH-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave NATO dhe BE, konfirmon pranë përfaqësuesve ushtarakë të vendeve përkatëse dhe përfaqësuesve ushtarakë të vendit tonë në vendet aleate dhe partnere, kandidaturat e miratuara dhe ndjek procedurat e nevojshme për përgatitjen dhe miratimin e urdhrit të ministrit, i cili duhet të dalë jo më vonë se 45 ditë nga fillimi i studimeve;
- dh) Kur të drejtat e studimeve ofrohen në një afat më pak se 150 ditë, DMBNJSH-ja, në bashkëpunim me J-1 dhe QPR-në/AFA, përcakton afatet që duhet të zbatohen deri në miratimin e kandidaturave;
- e) Qendra e Personel-Rekrutimit, brenda 15 ditëve, nga dalja e urdhrit për dërgimin me studime jashtë të kandidatëve dërgon në AFA një kopje të dosjes së kandidatëve të miratuar;
- ë) Akademia e Forcave të Armatosura, bazuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit 59/2014, të ndryshuar, si dhe udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 13 datë 8.10.2014 “Për procedurat e lidhjes së kontratës në shërbimin ushtarak”, lidh kontratën me kursantët/studentët, përpara fillimit të studimeve.

## DEKLARATË

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ lindur më \_\_\_\_\_

(emër atësi mbiemër)

me kartë identiteti/pasaporte nr. \_\_\_\_\_

1. Autorizoj Institucionin e Arsimit të Lartë \_\_\_\_\_ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu institucionin e Arsimit të Lartë, ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera me parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër, Atësi, Mbiemër i kandidatit

\_\_\_\_\_  
Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë

mësimore

Firma:

Firma:

Vendi:

Data: \_\_\_\_\_

# **FORMULAR I TË DHËNAVE PERSONALE TË APLIKANTIT/ APPLICANTS PERSONAL INFORMATION**

**ANEKSI A**

|                                                                                                                                                         |  |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| Name (Emri)                                                                                                                                             |  |
| Surname (Mbiemri)                                                                                                                                       |  |
| Date of birth (Datëlindja)                                                                                                                              |  |
| Place of Birth (Vendlindja)                                                                                                                             |  |
| Adress/Adresa e banimit                                                                                                                                 |  |
| Father's Name (Atësia)                                                                                                                                  |  |
| Mother's Name (Amësia)                                                                                                                                  |  |
| Sex (Male/Female)                                                                                                                                       |  |
| Passport Number/ ID Number                                                                                                                              |  |
| Occupation /Vendi i punës                                                                                                                               |  |
| E-mail address/ Adresë e-maili                                                                                                                          |  |
| Contact number, Cell Phone/<br>Numër kontakti                                                                                                           |  |
| Name of the academy you are<br>applying for (Emri i akademisë për të<br>cilën po aplikoni)                                                              |  |
| Academy you are applying for, write<br>numbers based on your preferences/<br>Akademia për të cilën po aplikoni,<br>rendisni me numra sipas preferencës. |  |
| Air Force Academy                                                                                                                                       |  |
| Navy Academy                                                                                                                                            |  |
| Marines Academy                                                                                                                                         |  |
| East Point Academy                                                                                                                                      |  |
|                                                                                                                                                         |  |
|                                                                                                                                                         |  |
|                                                                                                                                                         |  |
|                                                                                                                                                         |  |
|                                                                                                                                                         |  |
|                                                                                                                                                         |  |
|                                                                                                                                                         |  |

**Shënim:** Ky formular përdoret për ndjekjen e studimeve në akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit

**Signature/ Firma** \_\_\_\_\_

ANEKSI B

**FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR GJENDJEN SHËNDETËSORE TË  
KANDIDATIT PËR OFICER AKTIV**

Emri \_\_\_\_\_ Atësia \_\_\_\_\_ Mbiemri \_\_\_\_\_

Datëlindja \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

| Nr. | Probleme shëndetësore                                                                                                                | Po | Jo |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| 1.  | A keni marrë goditje në kokë këto 5 vitet e fundit?                                                                                  |    |    |
| 2.  | A keni pasur ndonjë tronditje në kokë këto 5 vitet e fundit ?                                                                        |    |    |
| 3.  | A keni pasur ndërhyrje kirurgjikale dentare brenda muajit të fundit ?                                                                |    |    |
| 4.  | A keni kryer ndërhyrje kirurgjikale në trupin tuaj?                                                                                  |    |    |
| 5.  | A keni pasur thyerje të kockave të ndryshme të trupit brenda 1 viti?                                                                 |    |    |
| 6.  | A keni marrë apo jeni duke marrë mjekim kundër përdorimit të alkoolit apo substancave narkotike të ndryshme ?                        |    |    |
| 7.  | A keni ndonjë shqetësim neurologjik apo psikologjik që lidhet me mirëfunksionimin e organizmit tuaj?                                 |    |    |
| 8.  | A keni pasur ndonjë shqetësim shëndetësor në zemër apo të tensionit arterial?                                                        |    |    |
| 9.  | A keni pasur apo keni ndonjë çrregullim apo infeksion të organeve të dëgjimit (veshit) dhe frymëmarrjes (hundës) në muajin e fundit? |    |    |
| 10. | A keni pasur probleme të tjera shëndetësore (nëse po specifiko problemin)?                                                           |    |    |

Shtetasi

\_\_\_\_\_  
(Emri Atësia Mbiemri)

Tabela me të dhëna për zhvillimin e testimeve të gjuhës angleze SAT, ACT dhe TOEFL

| Lloji i Testimit                                   | Adresat për regjistrim për testim                              | Rezultati minimal për pranim (matematikë) | Rezultati minimal për pranim (të lexuar) | Rezultati minimal për pranim (të lexuar) |
|----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------|
| Scholastic Aptitude Test (SAT)                     | <a href="http://www.collegeboard.com">www.collegeboard.com</a> | 560                                       | 450                                      |                                          |
| American College Testing (ACT)                     | <a href="http://www.act.org">www.act.org</a>                   | 25                                        | 18                                       |                                          |
| Test of English as a Foreign Language (TOEFL IBT*) | <a href="http://www.toefl.org">www.toefl.org</a>               |                                           |                                          | 80 pikë TOEFL IBT                        |

**Shënim.** Rezultatet e cilësuara në këtë tabelë konsiderohen rezultate konkurruese. Arritja e këtyre rezultateve nuk bën fitues asnjë aplikant.

Çdo aplikant duhet t'i nënshtrohet:

1. Testimit TOEFL;
2. Testimit SAT ose ACT.

Për testimin e zhvilluar aplikanti duhet të paraqesë dëshminë/certifikatën përkatëse.

**\*TOEFL IBT**- Test of English as a Foreign Language Internet Based Test

**UDHËZUES**

**PËR LLOGARITJEN E PIKËVE TOTALE TË MERITËS TË KANDIDATËVE QË DO  
TË REKRUTOHEN PËR NDJEKJEN E STUDIMEVE PËR OFICERË TË RINJ, NË  
AKADEMITË USHTARAKE BRENDA OSE JASHTË VENDIT**

**1. Llogaritja e pikëve dhe klasifikimi i kandidatëve.**

- a) Për kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët që do të ndjekin studimet në AFA, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë (minimumi bachelor), llogaritja e pikëve dhe klasifikimi i kandidatëve do të bëhet sipas rezultateve të arritura në:
- testimin fizik;
  - testimin intelektual;
  - testimin e gjuhës së huaj;
  - vlerësimin e diplomës së shkollës së mesme të lartë;
  - vlerësimin e 2 viteve të para të shkollës së mesme të lartë për ata kandidatë të cilët janë në vit të fundit të shkollës së mesme të lartë dhe të cilët kanë aplikuar për ndjekje studimesh në akademi ushtarake jashtë vendit.
  - vlerësimin e diplomës së shkollës së lartë (vetëm me kandidatët që do të ndjekin KPO të ri në AFA, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë);
- b) Për kandidatët që do të ndjekin studimet në programin e ciklit të parë bachelor në AFA, llogaritja e pikëve do të bëhet sipas rezultateve të arritura në:
- vlerësimin e diplomës së shkollës së mesme të lartë;
  - testimin fizik;
  - intervistën e pranimit dhe vlerësimin psikologjik.
  - testimin intelektual

**2. Sasia maksimale e pikëve që kandidati mund të marrë gjatë konkurrimit.**

- a) Për kandidatët që do të ndjekin studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit dhe me kandidatët që do të ndjekin KPO në AFA, ndarja e pikëve sipas disiplinave të testimit, është, si më poshtë (tabela 1):

Tabela.1

| Nr. | Ndjekja e studimeve bachelor në AFA dhe në akademitë ushtarake jashtë vendit       | Pikët maksimale që kandidati mund të marrë për vlerësimin e diplomës dhe në çdo disiplinë të testimit |                            |                                  |                                        |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|----------------------------------|----------------------------------------|
|     |                                                                                    | Vlerësimi i diplomës (M dhe L)                                                                        | Vlerësimi i testimit fizik | Vlerësimi i testimit intelektual | Vlerësimi i testimit të gjuhës së huaj |
| 1.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në AFA (kandidat me arsim të lartë)             | 30                                                                                                    | 25                         | 25                               | 20                                     |
| 2.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në SHBA, Britani e Madhe dhe Kosovë             | 30                                                                                                    | 25                         | 20                               | 25                                     |
| 3.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në Turqi, Itali dhe Greqi                       | 30                                                                                                    | 25                         | 20                               | 25                                     |
| 4.  | Rekrutimi për ndjekjen e studimeve në fushën e mjekësisë në Turqi, Greqi dhe Itali | 40                                                                                                    | 15                         | 20                               | 25                                     |

b) Për kandidatët që do të ndjekin programin e ciklit të parë të studimeve bachelor në AFA, ndarja e pikëve, sipas disiplinave të testimit, është, si më poshtë:

- vlerësimi i diplomës së shkollës së mesme të lartë, 40 pikë;
- testimi fizik, 20 pikë;
- intervista e pranimit dhe vlerësimi psikologjik, 30 pikë
- testimi intelektual 10 pikë

3. Llogaritja e pikëve të siguruara nga nota mesatare e 2 viteve të para të shkollës së mesme të lartë, diplomës së shkollës së mesme të lartë ose diplomës së shkollës së lartë.

- a) Për ata kandidatë të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë, nota mesatare e diplomës së shkollës së mesme të lartë do të konsiderohet nota që del nga pjesëtimi me 2, i shumës së notës mesatare të të gjitha viteve të shkollës dhe notës së provimeve të pjekurisë;
- b) Për ata kandidatë të cilët janë në vit të fundit të shkollës së mesme të lartë dhe që kanë aplikuar për ndjekje të studimeve në akademitë ushtarake jashtë vendit, nota mesatare e shkollës së mesme të lartë do të konsiderohet nota mesatare e 2 viteve të para të shkollës së mesme të lartë;
- c) Mesatarja e 2 viteve të para të shkollës së mesme të lartë, diploma e shkollës së mesme të lartë, si dhe diploma e shkollës së lartë vlerësohen me pikë, sipas germës “a” dhe “b”, të pikës 2.

- c) Llogaritja e pikëve të meritës të siguruara nga rezultatet e shkollës së mesme të lartë/shkollës së lartë bëhet sipas formulës:

$$SPDSHML/SPDSHL = Nmes \times P/10$$

**SPDSHML**- sasia e pikëve që kandidati mund të sigurojë nga vlerësimi i 2 viteve të para të shkollës së mesme të lartë, për ata kandidatë që janë në vit të fundit të shkollës së mesme, ose diplomës së shkollës së mesme të lartë, për ata kandidatë të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë.

**SPDSHL**-sasia e pikëve që kandidati mund të sigurojë nga vlerësimi i diplomës së shkollës së lartë.

**P**- Sasia maksimale e pikëve që kandidati mund të marrë.

**Nmes**-Nota mesatare.

#### 4. Llogaritja e pikëve të siguruara nga testimi fizik.

- a) Pikët maksimale që kandidati mund të sigurojë nga testimi fizik jepen në tabelën nr.1;  
b) Llogaritja e pikëve të testimit fizik bëhet sipas formulës:

$$SPTF = PTF \times P/300$$

**SPTF**- Sasia e pikëve të meritës që kandidati mund të sigurojë nga testimi fizik.

**PTF**- Sasia e pikëve që kandidati faktikisht ka marrë në testimin fizik, sipas Rregullores së Testimit Fizik.

**P**- Pesha e testimit fizik, e shprehur në pikë, në raport me sasinë e përgjithshme të pikëve (100), sipas germës “a” dhe “b” të pikës 2, e cila është e ndryshme dhe varet nga akademitë ushtarake ku do të ndjekin studimet kandidatët brenda ose jashtë vendit.

**300**-pikët maksimale që kandidati mund të marrë në testimin fizik, sipas Rregullores së Testimit Fizik.

- c) Sasia e pikëve të siguruara nga testimi fizik jepet në tabelën e mëposhtme.

| PTF | SPTF  | PTF | SPTF  | PTF | SPTF  | PTF | SPTF  | PTF | SPTF  |
|-----|-------|-----|-------|-----|-------|-----|-------|-----|-------|
| 180 | 12.00 | 205 | 13.66 | 230 | 15.33 | 255 | 17.00 | 280 | 18.66 |
| 181 | 12.06 | 206 | 13.73 | 231 | 15.40 | 256 | 17.06 | 281 | 18.73 |
| 182 | 12.13 | 207 | 13.80 | 232 | 15.46 | 257 | 17.13 | 282 | 18.80 |
| 183 | 12.20 | 208 | 13.86 | 233 | 15.53 | 258 | 17.20 | 283 | 18.86 |

|     |       |     |       |     |       |     |       |     |       |
|-----|-------|-----|-------|-----|-------|-----|-------|-----|-------|
| 184 | 12.26 | 209 | 13.93 | 234 | 15.60 | 259 | 17.26 | 284 | 18.93 |
| 185 | 12.33 | 210 | 14.00 | 235 | 15.66 | 260 | 17.33 | 285 | 19.00 |
| 186 | 12.40 | 211 | 14.06 | 236 | 15.73 | 261 | 17.40 | 286 | 19.06 |
| 187 | 12.46 | 212 | 14.13 | 237 | 15.80 | 262 | 17.46 | 287 | 19.13 |
| 188 | 12.53 | 213 | 14.20 | 238 | 15.86 | 263 | 17.53 | 288 | 19.20 |
| 189 | 12.60 | 214 | 14.26 | 239 | 15.93 | 264 | 17.60 | 289 | 19.26 |
| 190 | 12.66 | 215 | 14.33 | 240 | 16.00 | 265 | 17.66 | 290 | 19.33 |
| 191 | 12.73 | 216 | 14.40 | 241 | 16.06 | 266 | 17.73 | 291 | 19.40 |
| 192 | 12.80 | 217 | 14.46 | 242 | 16.13 | 267 | 17.80 | 292 | 19.46 |
| 193 | 12.86 | 218 | 14.53 | 243 | 16.20 | 268 | 17.86 | 293 | 19.53 |
| 194 | 12.93 | 219 | 14.60 | 244 | 16.26 | 269 | 17.93 | 294 | 19.60 |
